



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 74/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Nenad Lazic dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Aleksandar Jablanovic, përfaqësues nga Iniciativa Qytetare-Srpska Lista, dega në Leposaviq, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos certifikimit të kandidatit për deputet nga Iniciativa Qytetare-Lista Serbe, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2014, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i palejueshëm ankesa e Aleksandar Jablanovic, kryetar i Iniciativës Qytetare-Srpska Lista, dega në Leposaviq.

Arsyetim

PZAP-i me datën 23.05.2014, ka pranuar një ankesë nga Aleksandar Jablanovic, nga Iniciativa Qytetare-Srpska Lista dega në Leposaviq me të cilën pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin e tij nr 221/2014 të datës 21.05.2014 ka kërkuar nga “Srpska Lista” që kandidati i saj me numër rendor 001 Vladeta Kostic të dorëzojë dorëheqjen zyrtare nga organi legjislativ i një shteti tjetër. Sipas parashtruesit të ankesës vendimi i KQZ-së nuk është në përputhje me nenin 29.1 dhe pika 5 të LZP-së. Parashtruesi i ankesës pretendon se personi i cili është anëtarë i organit tjetër legjislativ nuk mund të fitoj ulëse si deputet, që do të thotë se nuk ka ndonjë pengesë ligjore të jetë kandidat dhe atëherë pas zgjedhjeve do duhej të ndërprej mandatin. Andaj me këtë rast kërkon nga PZAP-i, që vendimi i KQZ-së të refuzohet si i paligjshëm.

Lidhur me ankesën në fjalë PZAP-i e njoftoi KQZ-në dhe kërkoi nga ajo që të përgjigjet brenda afatit të paraparë.

PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar në të cilën theksohet se ZRPPC ka kërkuar nga Iniciativa qytetare Lista Serbe që kandidati në fjalë Vladeta Kostiq deri me datën 21.05.2014 ora 18:00 të sjell dëshminë zyrtare të dorëheqjes nga posti që mban në organin legjislativ të një shteti tjetër ose ta zavendsoj atë me një kandidat tjetër nga rradhët e iniciativës në fjalë. Më tutje sipas përgjigjes në fjalë theksohet se me datën 21.05.2014 Iniciativa në fjalë ka bërë zavendësimin e kandidatit Vladeta Kostiq me kandidatin tjetër Branimir Stojanovic dhe me datën 22.05.2014 zyra në bazë të kërkesës

së iniciativës qytetare Srpska Lista i ka rekomanduar KQZ-se zëvendësimin e kandidatit Vladeta Kostiq me kandidatin Branimir Stojanoviq.

PZAP-i, pas shqyrtimit lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

ankesa është e palejuar

PZAP-i konstaton se pretendimet ankimore për mos certifikimin e kandidatit për deputet nga rradhët e Iniciativës qytetare Lista Serbe nuk qëndrojnë pasi që nga shkresat e lëndës nuk shihet se ka ndonjë vendim nga KQZ me të cilin kandidatit nga Iniciativa në fjalë ju është refuzuar kërkesa për certifikim dhe se nuk ekziston vendim me numër protokoli të cekur në ankesë por ka vetëm një kërkesë të ZRPPC-së me të cilin i kërkohet kandidatit nga Lista Serbe për dorëzimin e dëshmisë të dorëheqjes nga posti që mban në Organin Legjislativ të një shteti tjetër. Saktësisht, nuk ekziston fare ndonjë vendim të KQZ-së me numër të protokolit dhe me datë të cekur në ankesë. Andaj në këtë rast meqë nuk ka vendim të KQZ-së me të cilin ju ka refuzuar kërkesa për certifikim për kandidatin Vladeta Kostiq, nuk është në juridiksionin e këtij institucioni për të vendosur për kërkesat e ZRPPC-së ngase sipas nenit 122.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht me dispozitën e sipërshtënuar. Andaj meqenëse pretendimet ankimore nuk janë në përputhje me dispozitën e lart theksuar PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 74/2014 më datën 26.05.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.